

BE, KLSH DHE SFIDAT E PROKURIMIT PUBLIK

nga Luljeta SHTYLLA – Audituese e Parë, Valentina GOLEMI –Audituese e Parë,
botuar në gazetën “Telegraf”, më 25 qershor 2015.



Prokurimi i mallrave, punëve dhe shërbimeve kryen misionin e tij me efektivitet dhe sjell të ardhura në Buxhetin e Shtetit, vetëm atëherë kur ka një koordinim të mirë ndërmjet katër shtyllave kryesore të këtij sistemi:

- 1) kornizës ligjore të shoqëruar me rregullore të detajuara;
- 2) kuadrit institucional;
- 3) fazës operationale dhe menaxhimit të tenderëve;
- 4) sistemit të kontrollit, monitorimit, dhe integritetit.

Mirëmenaxhimi i prokurimeve publike në vendet anëtare dhe ato kandidatë është përparësi e politikave të sotme të Bashkimit Evropian. Sfidat e përmirësimit të prokurimit publik në Shqipëri janë pjesë e axhendës së organizatave ndërkombëtare si OKB, OECD, por sidomos e vetë BE-së. Lind pyetja: sa të përshtatshme dhe të aplikueshme janë kriteret e vendosura nga ndërkombëtarët për specifikën politike, demografike, ekonomike dhe mjedisore të Shqipërisë? Ky shqetësim vjen si rrjedhojë e mungesës së informacionit se si direktivat e prokurimit dhe rregulloret për zbatimin e kodit praktik, të rekomanduara nga institucionet ndërkombëtare mund të përshtaten për të përmbushur nevojat e furnizuesve, kontraktorëve dhe autoriteteve të blerjes dhe sesi mund të maksimizohen kapacitetet e kompanive të vogla dhe të mesme në Shqipëri. Në këtë kontekst është thelbësore që të shtrohen një varg pyetjesh, si p.sh:

- 1) Sa efektive janë rregulloret aktuale të prokurimit në Shqipëri, parë nga perspektiva e furnizuesit, kontraktorit dhe autoriteteve të blerjeve?
- 2) Sa ndikojnë dhe si mund të përshtaten direktivat e BE-së mbi prokurimin publik në Shqipëri, duke përfshirë në prokurimin publik të bizneseve lokale, të vogla dhe të mesme, përdorimin e prokurimit publik për të avancuar objektivat ekonomike, sociale dhe mjedisore të politikave të qeverisë, kompleksitetin dhe fleksibilitetin e rregullave ekzistuese të prokurimit, vlerat e ofruara për paratë e shpenzuara?
- 3) A është korrupsioni në nivele të larta si rezultat i kulturës sonë lidhur me qëndrimin ndaj ligjit, apo është çështje e një sistemi prokurimi jo efikas (apo të dyja bashkë)?

4) Sa efektive janë trajnimet dhe kualifikimet aktuale në fushën e prokurimit publik?

Në datat 10-11 qershor 2015 në Luksemburg, në vijim të bashkëpunimit mes Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA) dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi çështjet të interesit të përbashkët, u zhvillua seminari me tematikë “Praktikat më të mira dhe auditimi i prokurimeve publike të fondeve të Bashkimit European, duke u bazuar në “Direktivën e Re për Prokurimet Publike në BE 2014/24/EU”, ku morën pjesë dhe dy audituese të KLSH. Qëllimi kryesor i aktivitetit ishte prezantimi i praktikave më të mira të auditimit mbi procedurat e prokurimeve publike të fondeve të Bashkimit European, nga ECA, auditime të realizuara në përputhje edhe me ndryshimet e miratuara nga Parlamenti Evropian dhe Këshillit të Evropës të Direktivës së Re për Prokurimet Publike në BE 2014/24/EU.

Auditues supremë nga shumë vende të Evropës (mes tyre dhe auditueset e KLSH-së) u njohën me një përmbledhje për Direktivat e mëparshme të Bashkimit European për prokurimet, ato që janë në fuqi aktualisht dhe krahasimi me miratimin e Direktivës së Re për Prokurimet Publike në BE 2014/24/EU, si një sfidë e kuadrit legjislativ të procedurave të prokurimeve publike të BE-së, me qëllimin e rritjes së mëtejshme e eficiencës dhe efikasitetit në procedurat tenderuese. Kjo Direktivë është miratuar në 26 shkurt 2014 nga Parlamenti European dhe Këshilli Europës dhe është e detyrueshme për t’u aplikuar nga të gjitha vendet e BE deri në vitin 2016, të gërshetuara me Kodin e Etikës së INTOSAI-t dhe aplikimin e ISSAI 30 në sektorin publik. Gjithashtu edhe vendet candidate të BE (mes të cilave dhe

vendi ynë), kanë detyrimin e përafrimit të legjislacionit të prokurimit publik me legjislacionin e BE.

Direktiva 2014/24/EU është e mbështetur në Strategjinë e Bashkimit Europian “Europe 2020”, dhe qëllimi kryesor saj është:

- Rritja e eficiencës në shpenzimet publike, duke zhvilluar një procedurë prokurimi në përmbushje të kriterëve ligjore, kapaciteve ekonomike, financiare dhe profesionale, në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, duke siguruar që autoritetet kontraktore të pronojnë oferta të cilat janë të përballueshme, të qëndrueshme, të pakushtëzuara dhe të plotësimit të nevojave të saj;
- Të ndihmojë SME (Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme) në pjesëmarrjen në procedurat e prokurimeve të fondeve të BE, duke i inkurajuar që operatorët ekonomike nga ana e tyre të jenë aktivë në krijimin e një marrëdhënie me integritet me entet publike;
- Të përmirësojë dhe lehtësojë procedurat e prokurimit në krahasim me Direktivën 2004/18/EC, duke i rishikuar dhe i modernizuar ato, duke mundësuar provedura më efektive në qëllimin e përbashkët social të vendeve anëtare të BE dhe kandidate. Në ndryshim me direktivat e tjera, Direktiva 2014/24/EU, i jep përparësi procedurës së negociimit të gjerë konkurrues;
- Të bëjë sa më të qartë nocionet dhe konceptet ligjore të shprehura në përmbajtjen e saj, në lidhje me parimet e përgjithshme të transparencës, trajtimit të barabartë dhe mos-diskriminimit. Për më

tepër, rregullat të veçanta të BE-së zbatohen për dhënien e kontratave publike për punë, mallra dhe shërbime, për sektorët klasikë, për utilitet dhe për fushat e mbrojtjes dhe sigurisë.

Direktiva 2014/24/EU është në përputhje të plotë me rregullat dhe ligjet ndërkombëtare, duke lehtësuar edhe pjesëmarrjen në proceset e prokurimeve edhe për firmat të cilat nuk i përkasin shteteve të Bashkimit Europian, duke maksimizuar transparencën e garës konkurrese dhe marrjen e masave mbrojtëse për të rritur integritetin, aty ku është e nevojshme përshtatja e legjislacionit nacional me atë të legjislacionit të BE.

Një këndvështrim i rëndësishëm i seminarit ishte fokusimi ndaj luftës kundër korrupsionit. Kjo Direktivë është shoqëruar me manuale praktike për të evituar parregullsitë, mashtrimet dhe manipulimin e procedurës së prokurimit. Duke qënë se kemi të bëjme me fonde publike që vihen në punë me qëllim realizimin e nevojave dhe interesave të publikut, vlerësohet si shumë i dobishëm aksesi me qëllim auditimi që ECA, duhet të bëjë mbi procedura prokurimi të rëndësishme dhe kontrata komplekse dhe me vlera të mëdha, të cilat në mënyrë më të ndjeshme dhe të drejtëpërdrejtë prekin interesat dhe portofolet e individëve (taxpaguesit). Kjo praktikë është e shoqëruar me një manual praktik, i cili përputhet me standardet e auditimit të Gjykatës Europiane të Audituesve dhe standardet INTOSAI. Këto manuale bëjnë të mundur lehtësimin e procedurës së auditimit nga ana e audituesve të ECA-s dhe audituesve të SAI-ve të vendeve anëtare.

Prokurimi publik në Shqipëri ka bërë progres të dukshëm në dekadën e fundit. Janë aplikuar metoda të reja bashkëkohore, si prokurimi elektronik

në vitin 2008, duke vazhduar në 2009 me futjen në sistem elektronik të të gjitha prokurimeve me vlerë më të madhe se 3 000 euro. Kjo është konsideruar nga Bashkimi Europian dhe institucionet e tjera ndërkombëtare si një nga arritjet më të mëdha që nga viti 1990.

Prokurimi i mallrave dhe shërbimeve për sektorin publik është thelbësor në veprimtarinë e çdo qeverie, për të inkurajuar rritje ekonomike afatgjatë dhe të qëndrueshme. Me fjalë të tjera, miradministrimi i fondeve buxhetore nëpërmjet koordinimit të katër shtyllave të përmendura më lartë, liria e informimit dhe kulturës së hapjes dhe transparencës, konkurrenca e lirë, ku bizneset e vogla lokale të jenë pjesë e kësaj konkurrence, pavarësisht ekzistencës së mentalitetit që këto biznese nuk kanë kapacitetet e duhura për t'iu përgjigjur kërkesave të tregut.

Nga KLSH po punohet për përgatitjen e një stafi profesional audituesish, me njohuritë e duhura në fushën e prokurimit me kualifikimet përkatëse. Trajnimet dhe rritja e kulturës profesionale në këtë fushë janë një armë e mirë për të luftuar korrupsionin në Shqipëri. Reforma e prokurimit publik do të ketë sukses, kur procesi të sigurojë mbështetje nga nivelet e larta politike, trajnime të plota për prokuruesit, legjislacioni modern dhe i përshtatshëm i prokurimit: si legjislacioni primar dhe aktet nënligjore zbatuese, informim për avantazhet e sistemit të ri dhe bashkëpunim në mes të sektorit publik dhe privat. Ky i fundit mundëson përfitime të ndërsjella, duke kuptuar më mirë problemet dhe nevojat e njëri-tjetrit.

Pavarësisht arritjeve, prokurimi publik në Shqipëri është larg standardeve europiane sepse korrupsioni është i lartë. Mungesa e konkurrencës është

evidente. Bizneset e vogla lokale nuk janë të inkurajuara që të jenë pjesë e procesit, për shkak se ekziston një mentalitet që këto kompani nuk janë të afta t'i përgjigjen kërkesave të tregut. Vihet re mungesa e një stafi të kualifikuar dhe njohurive në fushën e prokurimit publik, si dhe mungesa e koordinimit të katër shtyllave kryesore të sistemit të prokurimit publik. Në shumë raste kornizat ligjore janë komplekse dhe janë subjekt i interpretimeve individuale, ku lejohet hapësirë për abuzime dhe korrupsion.

Ndershmëria dhe saktësia në të gjitha fazat e prokurimit publik është një nga vlerat themelore që parandalon çdo lloj korrupsioni. Kjo është një ndër arsyet primare që Bashkimi Evropian e ka vendosur prokurimin publik si një prioritet, duke e quajtur atë “një sistem që gjeneron korrupsion”, që mund të shndërrohet në “kancer” që vonon zhvillimin ekonomik-social dhe “vret” konkurrencën e lirë.

Këto sfida bëhen akoma më të vështira, kur mendon brishtësinë dhe ndryshimet e vazhdueshme demografike, politike dhe ekonomike në vendin tonë, që mund të kenë impakt të drejtpërdrejtë në performancën e këtij sistemi dhe që mund të rezultojë në një përpjekje të dështuar të qeverisë për të ndërtuar një sistem fleksibël, të qëndrueshëm, afatgjatë, transparent, të besueshëm për publikun dhe që inkurajon rritje ekonomike. Mendojmë se çështjet e prokurimit publik tek ne duhen bërë subjekt i një diskutimi të gjerë, ku të përfshihen akademikë, profesionistë dhe praktikantë në lidhje me sfidat aktuale, reformat dhe përfitimet ekonomik-socialë dhe të mjedisit, nëpërmjet prokurimit publik, në përputhje me eksperiencën e praktikave të fundit të BE-së dhe ECA-s.